



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

Programi: **Bachelor**

Dega: **Biologji/Bioteknologji**

Lënda: KULTURË GJUHE

<i>Pedagogu:</i>	Prof. as. Lindita XHANARI
<i>Ngarkesa:</i>	2 ETCS (15 javë: 2 leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	I,II/II

Përshkrimi: Lënda “Kulturë gjuhe” synon të aftësojë studentët për të përdorur në mënyrë sa më korrekte shqipen standarde në nivele institucionale. Lënda është semestrare dhe është bazuar kryesisht në përmirësimin e nivelit të shkrimit të shqipes standarde. E konceptuar si një lëndë praktike, ajo është ndërtuar mbi bazën e njohurive praktike mbi gabimet më të përhapura në normën gramatikore, për të ngritur sa më shumë nivelin e njohjes së standardit të shqipes së shkruar. Në këtë lëndë trajtohen rregullat e drejtshkrimit të shqipes, të cilat studiohen të lidhura ngushtë me sistemin fonetik, morfologjik, fjalëformues e sintaksor të saj.

Temat e leksioneve:

1. Formimi i gjuhës letrare shqipe të njësuar. Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Kultura e gjuhës si pjesë përbërëse e kulturës kombëtare.
2. Probleme në përdorimin e shkronjave *e* dhe *ë* në pozicione të ndryshme në fjalë. Probleme në përdorimin e shkronjave *i*, *u*, *y*, *si* dhe të grupeve *ie*, *ye*, *ue*, *ua*.
3. Përdorimi i gabuar i apostrofit. Probleme në shkrimin e shkronjave: *sh*, *zh*, *ç*, *s*, *z*, *j*, *h*, *rr*, *nj* në trup të fjalës.
4. Çështje të shkrimit të grupeve: *mb*, *nd*, *ng*, *ngj* dhe të takimit të shkronjave: *t* me *sh*, *g*, *n* me *j*-në, etj.
5. Emrat e huaj të vendeve dhe të njerëzve-çështje të shkrimit të tyre. Probleme në përdorimin e saktë të shumësit të fjalëve.

6. Shkrimi i nyjës së përparme. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes. Përdorimi i shkronjave të mëdha.
7. Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit dhe shkrimi i datave. Çështje të përdorimit të emrave në rase. Përdorime të gabuara të përemrave në gjuhëshqipe.
8. Çështje të përdorimit të foljeve në mënyra dhe kohë të ndryshme.
9. Zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë të shqipes.
10. Variantet dialektore dhe krahinore. Ligjërimi i drejtë dhe ligjërimi i zhdrejtë.
11. Shenjat e pikësimit. Parimet e pikësimit. Klasifikimi i shenjave të pikësimit.
12. Teksti. Lidhëzat e tekstit. Paragrafi. Citimet dhe shënimet.
13. Njohuri mbi Programin e drejtshkrimit të Shqipes dhe përdorimin e tij. Gjetja dhe hartimi i bibliografisë. Radhitja dhe përgatitja për shtypje e një dokumenti.
14. Rishikimi. Redaktimi dhe korrektimi.
15. Shkrimi i një detyre kursi apo teme diplome.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- *Detyrim frekuentimi në: 70%* të seminareve

- *Angazhimi në seminare:* 10% e notës

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të 15% e notës

Testi 2 i pjesshëm në javën e 9-të 15% e notës

- *Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):* 20% e notës

- KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Testi përfundimtar javën e fundit 40% e notës

- *Gjithsej:* 100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973*

2. *Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 1976*

Literatura plotësuese:

1. Memushaj, R., *Shqipja standarde: si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.

2. Shkurtaj, Gj., *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.